



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), neneve 7 par.1.2 nënpar.1.2.1, 19 par.5 dhe 7 LIGJI Nr. 06/L-012 PËR KRYEQYTETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PRISHTINËN, nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur të Kuvendit Komunal më datë: __.__.2025 merr:

V E N D I M

për

Shfrytëzimin e Shërbimeve Shëndetësore pa pagesë për punëtorët e Komunës së Kryeqytetit – Prishtinës në të gjitha Qendrat e Shërbimeve Shëndetësore të Kryeqytetit

Neni 1

Miratohet Vendimi për Shfrytëzimin e Shërbimeve Shëndetësore pa pagesë për punëtorët e Komunës së Kryeqytetit – Prishtinës në të gjitha Qendrat e Shërbimeve Shëndetësore të Kryeqytetit.

Neni 2

Qendrat e Shërbimeve Shëndetësore të Kryeqytetit obligohen që të ofrojnë këto shërbime në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim në përputhje me aktet komunale.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Shëndetësi e cila do të bashkëpunojë me Qendrat e Shërbimeve Shëndetësore të Kryeqytetit.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

Kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit

Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më __.__.2025 merr:

V E N D I M

për

Shfrytëzimin e transportit rrugor urban pa pagesë për punëtorët e administratës së Komunës së Prishtinës - Kryeqyteti

Neni 1

Miratohet Vendimi për Shfrytëzimin e transportit rrugor urban pa pagesë për punëtorët e administratës së Komunës së Prishtinës - Kryeqyteti.

Ky vendim ka për qëllim sigurimin e shfrytëzimit pa pagesë të transportit publik urban për të gjithë punëtorët e administratës së Komunës së Prishtinës - Kryeqyteti.

Neni 2

Shfrytëzimi i transportit publik urban pa pagesë do të realizohet vetëm gjatë ditëve të punës dhe orarit zyrtar të punës.

Neni 3

Punëtorëve të administratës së Komunës së Prishtinës - Kryeqyteti do të pajisen me karta identifikuese për transport publik urban, të cilat do të jenë të vlefshme për të gjitha linjat urbane që operojnë në qytetin e Prishtinës

Karta identifikuese do të lëshohet nga NPL "Trafiku Urban" sh.a. në bashkëpunim me Drejtorinë për Administratë të Komunës së Prishtinës - Kryeqyteti.

Neni 4

Punëtorët e administratës së Komunës së Prishtinës - Kryeqyteti janë të obliguar të shfrytëzojnë kartelat vetëm për nevoja zyrtare dhe personale.

Çdo shkelje e kushteve të përcaktuara nga ky vendim mund të rezultojë me pezullimin e përfitimeve nga ky vendim.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Administratë dhe Drejtoria për Shërbime Publike në Komunë të Prishtinës – Kryeqyteti.

Çdo çështje operacionale që mund të lindë do të trajtohet nga një ekip i përbashkët i Komunës së Prishtinës – Kryeqyteti dhe NPL “Trafiku Urban” sh.a.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

**Kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit
Fehmi Kupina**



KËRKESË PËR FUTJEN NË REND TË DITËS (mbledhja e kuvendit e
datës: __/__/2025)

1. Miratimin e Vendimit për Shfrytëzimin e Shërbimeve Shëndetësore pa pagesë për punëtorët e Komunës së Prishtinës - Kryeqytetit – në të gjitha Qendrat e Shërbimeve Shëndetësore të Kryeqytetit;
2. Miratimin e Vendimit për Shfrytëzimin e transportit rrugor urban pa pagesë për punëtorët e administratës së Komunës së Prishtinës - Kryeqyteti



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



KOMUNA E PRISHTINËS
Zyrtari Kryesor Administrativ

Nr: _____
Datë: _____

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur të Kuvendit Komunal më datë: __.__.2025 merr:

V E N D I M për

Shfrytëzimin e transportit rrugor urban pa pagesë për punëtorët e administratës së Komunës së Prishtinës - Kryeqyteti

Neni 1

1. Miratohet Vendimi për Shfrytëzimin e transportit rrugor urban pa pagesë për punëtorët e administratës së Komunës së Prishtinës - Kryeqyteti.
2. Ky vendim ka për qëllim sigurimin e shfrytëzimit pa pagesë të transportit publik urban për të gjithë punëtorët e administratës së Komunës së Prishtinës – Kryeqyteti.

Neni 2

3. Shfrytëzimi i transportit publik urban pa pagesë do të realizohet vetëm gjatë ditëve të punës dhe orarit zyrtar të punës.

Neni 3

4. Punëtorëve të administratës së Komunës së Prishtinës – Kryeqyteti do të pajisen me karta identifikuese për transport publik urban, të cilat do të jenë të vlefshme për të gjitha linjat urbane që operojnë në qytetin e Prishtinës
5. Karta identifikuese do të lëshohet nga NPL "Trafiku Urban" sh.a. në bashkëpunim me Drejtorinë për Administratë të Komunës së Prishtinës – Kryeqyteti.

Neni 4

6. Punëtorët e administratës së Komunës së Prishtinës – Kryeqyteti janë të obliguar të shfrytëzojnë kartelat vetëm për nevoja zyrtare dhe personale.

7. Çdo shkelje e kushteve të përcaktuara nga ky vendim mund të rezultojë me pezullimin e përfitimeve nga ky vendim.

Neni 5

8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Administratë dhe Drejtoria për Shërbime Publike në Komunë të Prishtinës – Kryeqyteti.
9. Çdo çështje operationale që mund të lindë do të trajtohet nga një ekip i përbashkët i Komunës së Prishtinës – Kryeqyteti dhe NPL "Trafiku Urban" sh.a.

Neni 6

10. Ky Vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi Komunal i Prishtinës - Kryeqytetit.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
Kryeqytetit

Kryesuesi i Kuvendit të

____/____/25, me datë: ____/____/2025

Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



KOMUNA E PRISHTINËS
Zyrtari Kryesor Administrativ

Nr: _____

Datë: _____

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), neneve 7 par.1.2 nënpar.1.2.1, 19 par.5 dhe 7 LIGJI Nr. 06/L-012 PËR KRYEQYTETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PRISHTINËN, nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur të Kuvendit Komunal më datë: _____.2025 merr:

V E N D I M
për

Shfrytëzimin e Shërbimeve Shëndetësore pa pagesë për punëtorët e Komunës së Kryeqytetit – Prishtinës në të gjitha Qendrat e Shërbimeve Shëndetësore të Kryeqytetit

Neni 1

1. Miratohet Vendimi për Shfrytëzimin e Shërbimeve Shëndetësore pa pagesë për punëtorët e Komunës së Kryeqytetit – Prishtinës në të gjitha Qendrat e Shërbimeve Shëndetësore të Kryeqytetit.

Neni 2

2. Qendrat e Shërbimeve Shëndetësore të Kryeqytetit obligohen që të ofrojnë këto shërbime në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim në përputhje me aktet komunale.

Neni 3

3. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Shëndetësi e cila do të bashkëpunojë me Qendrat e Shërbimeve Shëndetësore të Kryeqytetit.

Neni 4

4. Ky Vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi Komunal i Prishtinës - Kryeqytetit.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

Kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit

____/____/25, me datë: ____/____/2025

Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Përmbledhje nga shqyrtimi i kërkesave nga takimet e mbajtura më 22-23 dhe 29 maj 2025 dhe ndryshimet e propozuar në takimin e datës 24.7.2025, të Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në kryeqytet.

Në mbledhje morën pjesë: **Bahri Gashi** - kryetar i komisionit dhe anëtarët: **Gëzim Sveçla, Fiknete Bejta, Muhamet Selmani, Sami Boroci, Endrit Zabërgja, Veton Krasniqi** nga Drejtoria e Urbanizmit.

Të pranishëm ishin edhe: **Luljeta Selimi, Zijadin Gashi, Shefki Jashari, Faton Marolli, Mimoza Mustafa** dhe **Arton Brahimi**.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Bahri Gashi, kryesues i komisionit**.

Para takimit të gjithë anëtarët e komisionit u njoftuan me kërkesat e drejtuara në Drejtorinë e Urbanizmit, për emërtimin, rifreskimin dhe ndryshimin e rrugëve në Komunën e Prishtinës.

Kryesuesi i komisionit filloi me procedimin e të gjitha kërkesave.

1. Kërkesa e parë, nr. 05-070/01-122803/24, dt. 18.09.2024, nga Enver Krasniqi, i cili kërkon zëvendësimin e emërimit të rrugës “Frashëri” në atë “Ibush Krasniqi”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës vendosi që kjo kërkesë të refuzohet, për arsye se komisioni nuk ka të drejtën e ndryshimit të adresave dhe në mungesë të dokumentacioneve në kërkesë.

2. Kërkesa nr. 15-015/02-128681/24, dt. 28.10.2024 nga Bajram Mjeku për emërtimin e një rruge në emër të “Gjon Destanishta”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës vendosi që ky propozim të jetë pjesë e listës rezervë të emrave për emërtimin e rrugëve dhe rrugicave në kryeqytet dhe të konsultohet me Shoqatën e historianëve.

3. Kërkesa nr. 14-015/02-104118/24, dt. 28.10.2024, nga Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, dega në Prishtinë e cila ka kërkuar që parku i ndërtuar në lagjen Kalabria afër shkollës “7 Marsi” të emërohet me emrin “Mejdi Asllani”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës vendos për miratimin e këtij emërtimi.

4.Kërkesa nr. 06-343/07-184642/23, dt. 06.09.2023, nga Ardit Sekiraqa për emërtimin e rrugës Mutivod-Dabishec, të emërohet me emërin “Sekiraqa”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës vendos për refuzimin e kësaj kërkesë, për arsye se Ligji për sistemimin e adresave, nuk lejon emërtimin e një rruge të njejtë me atë të qytetit përkatës apo ndonjë fshati.

5.Kërkesa nr. 06-343/07-137526/23, dt. 4.7.2023 nga Sami Dragusha, kërkon që një rrugicë e paemëruar në “Lagjen e Dragushëve” në fshatin Prugoc, të vendoset në emër të veteranit të arsimit “Xhemajl Dragusha”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës vendos për miratimin e këtij emërtimi.

6. Kërkesa nr. 06-343/07-42447/24, dt. 27.3.2024 nga Xhevat Reçica, i cili ka kërkuar që një rrugë në fshatin Vranidoll, të emërohet në emër të “Arif Reçica”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendosi për refuzimin e kërkesës, për arsye të mungesës së dokumentacionit.

7. Kërkesa nr. 05-015/01-66391/25, dt. 14.05.2025, nga familja Pireva dhe Këshilli i lagjes “Sofalia”, përfaqësues Enver Redenica, propozon që rruga e cila është duke u ndërtuar pranë ambulancës në “Sofali”, të emërtohet me emrin “Bejtë Pireva”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendosi për miratimin e kërkesës së banorëve.

8. Kërkesa nr. 05-070/01-82746/24, dt. 28.06.2024 nga Nexhat Peci, i cili kërkon që një objekt sportiv apo rrugë në Prishtinë të emërohet në emër të legjendës së boksit “Xhevdet Peci”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendosi për refuzimin e kërkesës për arsye të mungesës së komunikimit me familjarët.

9.Kërkesa nr. 05-015/02-2342024/23, dt. 19.12.2023 nga Tomor Kastrati, i cili kërkon që një rrugë të lagjen “Veternik”, në rrugën e “Shkupit”, e planifikuar për ndërtim të emërtohet në emër të “Mustafë Kastratit”.

- Komisioni pas shqyrtimit të kërkesës, vendos për refuzimin e kërkesës për shkak se e njëjta është në kundërshtim me Rregulloren për emërtimin e rrugëve dhe rrugicave dhe vendeve tjera publike.

10.Kërkesa nr. 05-015/02-229021/23, dt. 06.12.2023, nga Fatmir Ademi, i cili kërkon që një rrugë në fshatin Dabishec, të emërtohet në emër të “Xhemail Sadrija”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendosi për refuzimin e kësaj kërkesë, për arsye të mungesës së dokumentacionit- biografisë.

11. Kërkesa nr. 05-015/02-211334/23, dt. 26.10.2023, nga Iir Haziri, i cili kërkon që një rrugë në Lagjen Vaselovit Peraj, në fshatin Koliq të emërtohet në emër të “Halil Haziri”.

- Komisioni pas shqyrtimit të kërkesës, vendos për miratimin e saj, por duhet të diskutohet me banorët për sqarime të lokacionit të rrugës.

12. Kërkesa nr. 05-015/02-206144/23, dt. 13.10.2023, nga Halim Idriz Smaili, i cili kërkon që në vendin ku jeton rruga është pa adresë dhe kërkon që e njëjta të emërtohet me emrin “Halim Sopjani-Koprani”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për miratimin e kërkesës por kërkon kompletimin e dokumentacionit, listën me nëshkrime të lagjës.

13. Kërkesa nr. 05-015/02-18707/23, dt. 08.09.2023, nga Hysen Shulemaja, i cili kërkon që një rrugë private në lagjen “Kodra e Trimave”, të emërtohet në emër të “Ragip Shulemaja”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për miratimin e kërkesës.

14. Kërkesa nr. 05-015/02-180387/23, dt. 31.08.2023, nga Haki Reçica, i cili kërkon që një rrugë në pronë private në Vranidoll, të emërtohet në emër të “Sherif Reçica”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për refuzimin e kërkesës, për arsye të mungesës së nënshkrimeve të banorëve të lagjës.

15. Kërkesa nr. 05-015/02-179817/23, dt. 31.08.2023, nga Kadri Kaçuri, i cili këron që një rrugë në fshatin Prugoc, të emërtohet me emrin “Ibrahim Kaçuri”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për refunzimin e kërkesës, për arsyje të mungesës së dokumentacionit, nënshkrimeve të banorëve dhe biografisë.

16. Kërkesa nr. 05-015/02-170399/24, dt. 26.12.2024, nga Bekim Dugolli, i cili kërkon që një rrugë në kryeqytet të emërtohet me emrin “Fituesit Olimpik”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendosi për refuzimin e kërkesës, për arsye se propozimi i emrit është në kundërshtim me lokacionin.

17. Kërkesë nr. 05-015/02-170381/24, dt. 26.12.2024, nga Adem Zeka, i cili kërkon emërtimin e dy rrugëve në fshatin Nishec dhe Prapashticë, në emër të “Imer Zeka” dhe “Zabeli i Zekës”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendosi për refuzimin e kërkesës për arsye se rruga nuk është e ndërtuar dhe nuk është në kompetencën e komisionit.

18. Kërkesa nr. 05-015/02-142985/23, dt. 11.07.2023, nga Refik Kryeziu, i cili kërkon që rruga me kodin 107991, e cila quhet “Orhan Pojani” të zëvendësohet me emrin “Nevzat Kryeziu”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për miratimin e kërkesës, por në bashkëpunim me kërkuesin do të gjejnë një rrugë tjetër të përshtatshme për këtë emërtim, pasi rrugës së propozuar nuk mund ti ndryshohet adresa.

19. Kërkesa nr. 05-015/02-134957/24, dt. 15.10.2024, nga Uran Ramadani, i cili kërkon që një rrugë e lagjes në Bërnice e Epërme, të emërtohet në emër të “Xhemajl Ramadani”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për miratimin e kërkesës.

20. Kërkesa nr. 05-015/02-134642/24, dt. 14.10.2024, nga Ajet Brajshori, i cili kërkon që një rrugë në fshatin Sharban të emërtohet me emrin “Ajet Fazli Brajshori”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për miratimin e kërkesës.

21. Kërkesa nr. 06-015/02-121957/24, dt. 16.9.2024, nga Remzi Haradini, i cili kërkon që një rrugë në fshatin Prapashticë afër rrugës “Shijaku”, të emërtohet në emër të “Haradin Haradinit”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për miratimin e kërkesës.

22. Kërkesa nr. 05-015/02-117846/24, dt. 06.09.2024, nga Bujar Hoxha, i cili kërkon që një rrugë private në fshatin Bardhosh, të emërtohet me emrin “Leka”.

- Komisioni vendos për refuzimin e kërkesës, për arsye se emri i propozuar nuk përshtatet me lokacionin e kërkuar të rrugës.

23. Kërkesa nr. 05-015/02-117633/24, dt. 06.09.2024, nga Afrim Veseli, i cili kërkon që një rrugë e shtruar me zhavor të emërtohet me emrin “Kroni i ëmbël”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për refuzimin e kërkesës me arsye se kërkesa është e drejtuar vetëm individualisht, jo me peticionin e banorëve.

24. Kërkesa nr. 05-015/02-115633/24, dt. 02.09.2024, nga Fahri Ademi, përfaqësues i fshatit Sharban, i cili kërkon që një rrugë në lagjen e Hetajve, të emërtohet me emrin “Halim Ademi”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për miratimin e kërkesës, por në bashkëpunim me kërkuesin do të gjejnë një rrugë tjetër të përshtatshme për këtë emërtim, pasi rrugës së propozuar nuk mund ti ndryshohet adresa.

25. Kërkesë nr. 05-015/02-112544/24, dt. 26.8.2024, nga Fatmir Krasniqi, i cili kërkon që një rrugë në lagjen Butoc, fshati Makoc, të emërtohet me emrin “Rexhep Koprani”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për miratimin e kërkesës.

26. Kërkesë nr. 05-015/02-112211/24, dt. 26.8.2024, nga Fatmir Behrami, i cili kërkon që një rrugë te vendi i quajtur “Bunari i Hajratit”, të emërtohet me emrin e babit të tij “Sabri Behrami”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, është për miratimin e kërkesës, por refuzohet për shkak të aspekteve ligjore.

27. Kërkesa nr. 05-015/02-110548/24, dt. 22.08.2024, nga Sami Shaqiri, i cili kërkon që një rrugë në fshatin Koliq, te rrethrotullimi apo rruga “Martirët dhe Mursel Goxhufi”, të emërtohet me emrin “Kadri Shaqiri”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për refuzimin e kërkesës për arsye të mungesës së dokumentacionit.

28. Kërkesa nr. 05-015/02-110044/24, dt. 21.08.2024, nga Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës, të cilët kërkojnë që pjesa prapa Qendës tregtare në “Bregun e Diellit”, të bëhet shesh dhe të emërtohet në emër të “Abdyl Kadollit”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos që ky emër të jetë pjesë e listës rezervë të emrave dhe të njëjtit i kërkohet ndryshim i rrugës në një lokacion tjetër.

29. Kërkesa nr. 05-015/02-97553/24, dt. 26.7.2024, nga Shefki Krasniqi, i cili kërkon që vendi i quajtur “Arat e Qafës”, të emërtohet me emrin “Baki Brahim Grashtica”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për miratimin e kërkesës, por në bashkëpunim me kërkuesin do të gjejnë një rrugë tjetër të përshtatshme për këtë emërtim, pasi rrugës së propozuar nuk mund ti ndryshohet adresa.

30. Kërkesa nr. 05-015/02-90846/24, dt. 12.7.2024, nga Bekim Hamiti, në emër të banorëve të fshatit Bardhosh dhe Bërnice, ka kërkuar që rruga “Stefan Makrenjavc”, të zëvendësohet me emrin “Hizri Gubetini”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për miratimin e kësaj kërkesë e cila nxit promovimin e njërzve, të cilët janë marrë me sport në përfaqësimin e tyre dhe ndërlidhjet që ka pasur me rrugën.

31. Kërkesa nr. 05-015/02-90642/24, dt. 12.7.2024, nga Nuha Zullufi, i cili kërkon që rruga në fshatin Koliq që lidhet me Prishtinën, të emërtohet në emër të “Zullufi”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për refuzimin e kërkesës duke u bazuar në nenin 9, pika 1.4 të Ligjit Nr. 04/L-071 për sistemin e adresave, i cili bën ndalimin e emërtimeve në emrat e familjeve.

32. Kërkesa nr. 05-015/02-65014/24, dt. 21.5.2024, nga Artan Duriqi, i cili kërkon që një rrugë apo shesh në Prishtinë të emërohet me emrin “Xhemshit Duriqi”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos që ky emër të jetë pjesë e listës rezervë të emrave.

33. Komisioni duke u bazuar në nenin 9, pika 1.3 të Ligjit Nr. 04/L-071 për sistemin e adresave, ka propozuar të shqyrtohet dhe të shikohen faktet për korrigjimin e emrit të rrugës nga “Mark Dizdari” në “Mak Dizdari”.

34. Kërkesë nr. 01-015/02-72366/25, dt. 23.05.2025, nga Fehmi Kupina - Kryesues i Kuvendit të Kryeqytetit, i cili kërkon emërtimin e një rruge në emër të “Xhevat Makollit”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos që ky propozim të jetë pjesë e listës rezervë të emrave.

35. Kërkesa nr. 05-015/02-49716/24, dt. 17.04.2024, nga Bashkësia lokale e fshatit Dabishec, Rahman Hyseni, i cili kërkon që një rrugë në lagjen “Llapsidejë”, të emërtohet me emrin “Ejup Hyseni”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos që ky emër të jetë pjesë e listës rezervë të emrave.

36. Kërkesa nr. 05-015/02-30360/25, dt. 27.02.2025, nga Blend Demolli, i cili kërkon zëvendësimin e emrit të rrugës “Follorim”, në emër të “Besfort Demollit”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos që ky emër të jetë pjesë e listës rezervë të emrave.

37. Kërkesa nr. 05-015/02-20301/25, dt. 7.2.2025, nga Vigan Hoxha, i cili kërkon që një rrugë në “Tophane”, të emërtohet me emrin “Ramadan Hoxha”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendosi që rruga në lagjen “Tophane” të emërohet me këtë emër.

38. Kërkesa nr. 05-015/02-18577/25, dt. 5.2.2025, nga Afrim Ramadani, i cili kërkon që rruga në “Lagjen e Çesollëve” në fshatin Keqekollë, të emërtohet me emrin “Mustaf Ramadani”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për miratimin e kërkesës.

39. Kërkesa nr. 05-015/02-7030/24, dt. 12.1.2024 nga Muhamet Gubetini, i cili kërkon që rruga Sharban-Rimanishtë, të emërtohet me emrin “Sabit Gubetini”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për aprovimin e kërkesës.

40. Kërkesë nga Fitim Xhukolli, i cili kërkon që një rrugë në fshatin Nishec, të emërohet me emrin “Hatixhe Xhukolli”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për refuzimin e kërkesës për arsye të mungesës së dokumentacionit.

41. Kërkesë nga Fitim Xhukolli, i cili kërkon që një rrugë në Matiçan, të emërtohet në emër të “Nazmi Xhukollit”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për refuzimin e kërkesës për arsye se rruga është e emërtuar me emër tjetër.

42. Kërkesa nr. 05-015/02-82863/24, dt. 28.6.2024, nga Agon Hashimi, i cili kërkon që një rrugë apo shesh në Prishtinë, të emërtohet me emrin “Shaban Hashimi”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendosë që ky emër të jetë pjesë e listës rezervë të emrave.

43. Kërkesa nr. 05-015/01-41734/24, dt. 26.3.2024, nga Besart Reçica, i cili kërkon që një rrugë në fshatin Vranidoll, të emërtohet në emër të “Nemer Isat Reçica”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për aprovimin e kërkesës.

44. Kërkesa 05-015/01-37697/24, dt. 15.03.2024, nga Naim Gashi, në lidhje me emërtimin e një rruge.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për refuzimin e kërkesës, për arsye të mungesës së dokumentacionit.

45. Kërkesa nr. 01-070/01-114324/24, dt. 30.08.2024, nga z. Fehmi Kupina, Kryesues i Kuvendit të Kryeqytetit, në kërkesën e drejtuar nga Flurije Morina, kërkohet që rruga e emërtuar “Mehmet Akif Ersoy”, të zëvendësohet me emrin “Faton Morina”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për miratimin e kërkesës por me ndryshim lokacioni në bashkëpunim me familjen.

46. Kërkesa nr. 01-016/01-147775/24-1, dt. 07.11.2024, nga z. Fehmi Kupina, Kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit, ka kërkuar që një rrugë të emërtohet me emrin “Muhamet Pirraku”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, ka miratuar kërkesën dhe ka vendosur që vazhdimi i rrugës “Bernard Kushner”, në mes rrugës “Tirana” dhe “Bashkim Fehmiu”, të emërohet në emër të “Muhamet Pirraku”.

47. Kërkesa nr. 01-015/01-61722/24, dt. 14.5.2024, nga Muharrem Rama, i cili ka kërkuar që një rrugë anësore në lagjen “Rama”, në fshatin Koliq të emërtohet në emër të “Imer Rama”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, ka vendosur për miratimin e kërkesës.

48. Kërkesa nr. 05-015/02-88501/23, nr. 3.5.2023, nga Behxhet Reçica, përfaqësues i fshatit Vranidoll, ka kërkuar që rrugët “Konsipoli”, “Liçeni i Prespës” dhe “Kaonët”, të zëvendësohen me emrat “Mehmet Reçica”, “Sadik Reçica” dhe “Ramë Reçica”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, ka vendosur për refuzimin e kërkesës pasi komisioni nuk ka kompetencë të ndryshimit të adresave, nga komisioni tjetër deri në kalimin e afatit 10 - vjeçar.

49. Kërkesa nr. 01-015/02-71902/25, e dt. 23.05.2025, nga z. Fehmi Kupina, Kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit, ka kërkuar që një rrugë të emërtohet me emrin “Naser Brahimaj – Bardheci”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, ka vendosur që ky emër të jetë pjesë e listës rezervë të emrave.

50. Kërkesa nr. 01-015/02-71908/25, e dt. 23.05.2025, nga z. Fehmi Kupina, Kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit, ka kërkuar që një rrugë të emërtohet me emrin “Masar Kadiu”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, ka vendosur që ky emër të jetë pjesë e listës rezervë të emrave.

51. Kërkesa nr. 05-015/02-71810/25, e dt. 22.05.2025, nga Agon Abazi, në emër të banorëve të lagjes “Matiçan”, ka kërkuar që ish-rruga “Sylejman Pitarka”, që lidhet me rrugën kryesore “Papa Gjonpali”, të emërtohet me emrin “Shaban Abazi”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, ka vendos për refuzimin e kërkesës për arsye të mungesës së dokumentacionit dhe nënshkrimeve të banorëve.

52. Kërkesa nr. 01-015/02-72382/25, dt. 23.05.2025, nga Emin Sallahu, i cili ka kërkuar që një rrugë në fshatin Orloviq, të emërtohet me emrin “Jonuz Sallahu”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, ka vendosur për miratimin e kërkesës.

53. Kërkesa nr. 01-015/02-72381/25, dt. 23.05.2025, nga Gazmend Makolli, i cili ka kërkuar që një rrugë në lagjen “Veternik” të emërtohet me emrin “Hamit Makolli”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, ka vendosur për aprovimin e kërkesës.

54. Kërkesa 01-015/02-72376/25, dt. 23.05.2025, nga Fahri Fazliu, i cili ka kërkuar emërtimin e një rruge apo sheshi në emër të “Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, ka vendosur që parku në Bregun e Diellit afër banesës që gjendet në mes rrugës “2 Korriku” dhe “Vëllezërit Gërvalla”, të emërtohet me emrin “Parku Memorial, Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu”.

55. Kërkesa nr. 01-015/02-72370/25, dt. 23.05.2025, nga z. Fehmi Kupina, Kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit, ka kërkuar që një rrugë të emërtohet me emrin “Ramadan Keqa”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, ka vendosur që të jetë pjesë e listës rezervë të emrave deri në caktimin e një lokacioni të përshtatshëm.

56. Kërkesa nr. 05-015/02-71940/25, dt. 22.05.2025 nga Arsim Janova, i cili ka kërkuar që një segment i rrugës “Bedri Shala”, te kryqëzimi i rrugës “Abdyl Frashëri” dhe “Shaip Spahija”, të emërohet me emrin “Ahmet Janova”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës dhe rishikimit të lokacionit ka vendosur për miratimin e adresës.

57. Kërkesë nr. 05-015/02-72454/25, e dt. 23.05.2025, nga Familja Limaj, e cila ka kërkuar që një rrugë në kryeqytet të emërtohet në emër të “Kadri Limaj”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, ka miratuar kërkesën, por vetëm të gjendet lokacioni i përshtatshëm.

58. Kërkesa nga Bekim Rustemi, i cili ka kërkuar që një rrugë në fshatin Prapashticë të emërtohet me emrin “Buna 37”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, ka miratuar kërkesën.

59. Kërkesa nr. 05-015/02-72144/25, dt. 23.05.2025, nga Bashkim Latifi, i cili kërkon emërtimin e një rruge në emër të “Isuf Sahit Latifi”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, ka vendosur për miratimin e kërkesës por në bashkëpunim me familjarët të vendoset për lokacionin.

60. Kërkesa nr. 05-015/02-72050/25, e dt. 23.05.2025, Familja Vitia, përfaqësues Afrim Vitia, ka kërkuar që rruga e pa emëruar përballë stadiumit të Hajvalisë, e cila lidhet me rrugën “Rexhep Bajrami”, të emërohet në emër të “Hasan Vitija”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për miratimin e kërkesës.

61. Kërkesa nr. 05-015/02-70201/25, të dt. 21.05.2025, Ragip Lutolli, Kryesues i Këshillit në Arbëri, ka kërkuar zëvendësimin e rrugës “Tomas Hobsi”, në emër të “Arif Lutolli”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për refuzimin e kërkesës për shkak se komisioni nuk e ka të drejtën e ndryshimit të adresave.

62. Kërkesa nr. 05-015/02-71736/25, të dt. 26.05.2025, Feti Vitia ka kërkuar zëvendësimin e rrugës “Agim Bajrami”, në lagjën Hajvalia, në emër të “Fatmir Vitia”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për refuzimin e kërkesës për shkak se komisioni nuk e ka të drejtën e ndryshimit të adresave.

63. Kërkesa nr. 01-015/01-0074040/25, dt. 27.05.2025, Muharrem Rama ka kërkuar që rruga “Martirët” të zëvendësohet me emrin “Dëshmorët Rama”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, vendos për refuzimin e kërkesës për shkak se komisioni nuk e ka të drejtën e ndryshimit të adresave.

64. Kërkesa nr. 05-015/02-73077/25, e dt. 26.05.2025, Bajram Krasniqi ka kërkuar që një rrugë në Grashticë, në mahallën e Sherifoviqe, të emërohet me emrin “Haxhi Bejta”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës, ka aprovuar kërkesën.

65. Komisioni ka vendosur që rruga në Kolovicë, me kodin 11534, të emërohet në emër të “Sefedin Shabani”.

66. Kërkesa nr.14-016/01-77807/25, e dt. 09.06.2025, nga Baton Dushi, i cili kërkon që rruga “Halit Krasniqi”, të ndrrohet dhe të emërohet në emër të akademik “Minir Dushi”.

- Komisioni pas shqyrtimit të kërkesës, vendos për refuzimin e kërkesës për shkak se komisioni nuk ka kompetencë për ndryshimin e adresave.

67. Kërkesë nr. 05-015/02-96710/25, e dt. 04.07.2025, nga banorët e fshatit Barilevë, përfaqësues Riad Sinani, të cilët kërkojnë emërimin e një rruge, afër rrugës “Mulla Ahmet Çunaku”, në emër të “Ahmet Sinani”.

- Komisioni pas shqyrtimit të kërkesës vendos për refuzimin e kërkesës, për shkak të mungesës së biografisë.

68. Kërkesa nr. 05-015/02-94299/25, e dt. 30.6.2025, nga Hajriz Kameri, i cili kërkon emërimin e një rruge në fshatin “Keqekollë”, në lagjen e Govorëve, në emër të “Imer Hajrizit”.

- Komisioni vendos për miratimin e kërkesës.

69. Kërkesa nr. 05-015/02-93878/25, e dt. 30.6.2025, nga Admirim Kuliqi, i cili kërkon emërimin e një rruge në Hajvali, në emër të “Halil Kosumit”.

- Komisioni pas shqyrtimit të kërkesës vendos për refuzimin e kërkesës, për shkak të mos plotësimit të kushteve për miratimin e kërkesës.

70. Kërkesa nr. 05-015/02-85245/25, e dt. 17.6.2025, nga Merita Maloku, e cila kërkon emërmin një rruge, në kryqëzimin e rrugës “Nijazi Azemi”, në emër të “Halil Rexhep Maloku”.

- Komisioni pas shqyrtimit të kërkesës vendos për refuzimin e kërkesës, për shkak të mos plotësimit të kushteve për miratimin e kërkesës.

71. Kërkesa nr. 05-015/02-84217/25, e dt. 16.6.2025 nga Shoqata e familjeve të dëshmorëve të UÇK-së, Dega në Prishtinë.

- Komisioni pas shqyrtimit të kërkesës, aprovoj kërkesën dhe vendosi që emrat e propozuar në kërkesë të jenë pjesë e listës rezervët të rrugëve, përveq dy emrave të cilët janë të emëruar.

72. Kërkesa nr. 05-015/01-91003/25, e dt. 24.6.2025, nga Selman Bogiqi, i cili kërkon emërimin e një rruge në emër të “Fetah Bogiqit”.

- Komisioni pas shqyrtimit të kërkesës vendos, që emri i propozuar të jetë pjesë e listës rezervë të adresave.

73. Kërkesa nr. 05-070/01-105134/25, e dt. 21.7.2025, në emër të Burim Krasniqi, i cili kërkon që rruga “Sami Pojani”, të zëvendësohet me emrin “Lauran Kadriu”.

- Komisioni pas shqyrtimit të lëndës vendos për refuzimin e kërkesës për shkak se nuk është kompetenc e komisionit ndryshimi i adresave.

74. Kërkesa nr. 05-015/02-72317/25, e dt. 23.05.2025, nga banorët e kompleksit “Ramiz Sadiku”, përfaqësuese Lorika Govori-Shabani, të cilën kanë kërkuar që rruga të zëvendësohet me emrin “Besim Govori”.

- Komisioni pas shqyrtimit të kërkesës, vendos për refuzimin e kërkesës për shkak se nuk është në kompetencen e komisionit.

75. Kërkesa nr. 05-015/02-121917/25, e dt. 15.08.2025, në emër të Anduena Beqiri, e cilia kërkon emërimin e një rruge në emër të “Vëllezrit Beqiri”.

- Komisioni pas shqyrtimit të kërkesës vendos, që emri i propozuar të jetë pjesë e listës rezervë të adresave.

Komisioni ka propozuar emërat të gjinisë femërore për emërtim të rrugëve, të cilët do të shqyrtohen në mbledhjen e radhës:

- Sevdije Mehmeti
- Burbuqe Berisha
- Vjosa Berisha
- Edi Shukriu
- Nexhmije Pagarusha
- Sahadete Mekuli
- Leze Qena
- Liza Vorfi dhe
- Xhevrije Arifi.

Procesmbajtësi
Arton Brahimi

Kryesues i Komitetit
Bahri Gashi

Anëtarët e Komisionit:

- 1- Gëzim Sveçla _____
- 2- Fiknete Bejta _____
- 3- Muhamet Selmani _____
- 4- Sami Boroci _____
- 5- Endrit Zabërgja _____
- 6- Veton Krasniqi _____

(zyrtar nga Drejtoria e Urbanizmit)

LËNDA:

Raport mbi punën e Komisionit për rifreskimin e Listës Rezervë të emërtimeve të rrugëve

I nderuar Kryetar i Asamblesë Komunale,

Të nderuar anëtarë të Asamblesë,

Në përputhje me vendimin e Drejtorisë së Urbanizimit dhe Mjedisit të datës 03.04.2023, është themeluar Komisioni për rifreskimin dhe rishikimin e Listës Rezervë të emrave të rrugëve, me qëllim të përmirësimit, korrigjimit dhe përditësimit të listës ekzistuese në bazë të kërkesave të pranura nga qytetarët dhe subjekte të tjera.

PËRBËRJA E KOMISIONIT

Në mbledhjet e komisionit kanë marrë pjesë anëtarët në vijim:

- Bahri Gashi – Kryetar i Komisionit
- Gëzim Sveçla – Anëtar
- Fiknete Bejta – Anëtare
- Muhamet Selmani – Anëtar
- Sami Boroci – Anëtar
- Endrit Zabërgja – Anëtar
- Veton Krasniqi – Përfaqësues nga Drejtoria e Urbanizimit

OBJEKTIVAT E PUNËS

Komisioni është angazhuar në:

- Rishikimin e Listës Rezervë ekzistuese;
- Korrigjimin e gabimeve teknike dhe gjuhësore në emrat ekzistues;
- Shqyrtimin dhe analizimin e kërkesave të qytetarëve për propozime të reja të emërtimeve;
- Përgatitjen e një liste të përditësuar për përdorim të ardhshëm institucional.

PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE

Gjatë periudhës prill 2023 – korrik 2025 komisioni ka shqyrtuar gjithsej 108 kërkesa për emërtime të reja ose ndryshime të emrave ekzistues.

Kategoria	Numri i kërkesave	Përshkrim
Të aprovuara për përdorim aktiv	30	Emra që i plotësojnë kriteret ligjore, historike dhe kulturore
Të refuzuara	31	Refuzuar për arsye teknike, ligjore, ose për shkak të përsëritjes
Të pranuar në Listën Rezervë	47	Emra të vlefshëm për përdorim të ardhshëm, sipas nevojës

VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM

Komisioni ka vepruar në përputhje me udhëzimet dhe standardet ligjore në fuqi, duke pasur parasysh aspektet gjuhësore, kulturore dhe historike të emërtimeve. Procesi është zhvilluar me transparencë dhe me pjesëmarrjen aktive të përfaqësuesve institucionalë.

REKOMANDIMET

1. Të miratohet nga Asambleja Komunale lista e rifreskuar e emrave rezervë;
2. Të publikohet lista për informim të qytetarëve;
3. Të parashihen përditësime periodike të listës në bazë të kërkesave të reja dhe zhvillimeve në terren.

BASHKËNGJITJE:

- Lista e emrave të aprovuar për përdorim;
- Lista e kërkesave të refuzuara me arsyetim përkatës;
- Lista e emrave të pranuar në rezervë;
- Procesverbalet e mbledhjeve të komisionit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/ L – 040, për vetëqeverisje lokale dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më, merr këtë:

V E N D I M
PËR SHLYERJEN E BORXHIT TË KOMPANISË RAJONALE TË
MBETURINAVE “PASTRIMI” SHA, NDAJ KOMPANISË PËR MENAXHIMIN E
DEPONIVE NË KOSOVË (KMDK-SË)

1. Miratohet shlyerja e borxhit të Kompanis rajonale të mbeturinave “Pastrimi” SHA, ndaj Kompanisë për Menagjimin e Deponive në Kosovë (KMDK-së).
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, shuma e mjeteve që ndahet është në vlerë prej , . €
(-----), shumë kjo e siguruar nga kategoria -----
3. Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare për shlyerjen e borxhit të Kompanisë rajonale të mbeturinave “Pastrimi” SHA, ndaj Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK-së).
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Kryeqytetit dhe Drejtoria e Financave.
6. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

Raporti i Zgjedhjeve të Këshillave Lokale

Në periudhën 2023-2025, janë zhvilluar zgjedhjet për kryetarë dhe kryesi të Këshillave Lokale të Kryeqytetit. Qëllimi i këtyre zgjedhjeve ishte përzgjedhja e kryetarëve dhe anëtarëve të këshillave, të cilët do të udhëhiqen nga interesat dhe nevojat e komunitetit.

Çdo Këshill Lokal ka zhvilluar një proces zgjedhor unik, ku banorët kanë pasur mundësinë të votojnë për kandidatët që do t'i përfaqësonin në strukturat drejtuese lokale. Këto zgjedhje kanë sjellë rezultate të ndryshme në secilën bashkësi, duke pasqyruar kështu preferencat e banorëve për udhëheqësit e ardhshëm.

Këshilli Lokal – Qendra

Në datën 18 Qershor 2024, zgjedhjet për kryetar u mbajtën në Qendër. Sadudin Hasani u zgjodh kryetar me 42 vota, duke lënë pas Donat Mehmetaj (31 vota) dhe Sadudin Berishën (29 vota).

Këshilli Lokal – Lakrishtë

Më 14 Qershor 2024, Jahë Balaj u rizgjodh kryetar pas një gare me Mirlinda Jasharin. Balaj fitoi me 64 vota, ndërsa Jashari mori 52.

Këshilli Lokal – Dardania

Më 22 Maj 2025, zgjedhjet për kryetar u mbajtën në Dardani, ku Hatixhe Hertica doli fituese pas balotazhit me Ismet Barilevën. Hertica fitoi me 129 vota më 10 Qershor.

Këshilli Lokal – Ulpiana

Në 2 Maj 2024, zgjedhjet për kryetar u zhvilluan mes Lum Osmanit dhe Florent Gashit. Lum Osmani fitoi me 129 vota, kundrejt 118 të Gashit.

Këshilli Lokal – Tophane

Më 10 Qershor 2024, Masar Sllovinja u zgjodh kryetar pas një balotazhi me Naim Kaçiun. Në raundin e parë, Sllovinja mori 85 vota, ndërsa në balotazh fitoi me 174 vota, kundrejt 132 të Kaçiut.

Këshilli Lokal – Kalabria 1

Në 23 Prill 2024, Milot Krasniqi fitoi pas një gare me Hilmi Halilin, duke marrë 94 vota kundrejt 35 të tij.

Këshilli Lokal – Kalabria 2

Në 6 Maj 2025, Arbnor Neziri u zgjodh kryetar me aklamacion, pasi ishte i vetmi kandidat.

Këshilli Lokal – Cagllavica 1

Më 12 Qershor 2025, Driton Mullarama u zgjodh kryetar me aklamacion, duke qenë i vetmi kandidat.

Këshilli Lokal – Cagllavica 2

Më 12 Qershor 2025, Deli Avdiu fitoi pas një gare me Mimoza Rexhepin, duke marrë shumicën e votave.

Këshilli Lokal – Hajvalia

Në 18 Maj 2023, Ilmi Vitija u zgjodh kryetar me aklamacion.

Këshilli Lokal – Prishtina e Re 1

Në 22 Prill 2025, Naim Duboleva u zgjodh kryetar pas një gare me Sahit Ademin, duke fituar 24 vota kundrejt 20 të Ademit.

Këshilli Lokal – Prishtina e Re 2

Zgjedhjet për këtë këshill u anuluan.

Këshilli Lokal – "Mati I" - Jugu

Më 10 Prill 2025, Dren Shahini u zgjodh kryetar pas një gare me Florim Kurtin, duke fituar 105 vota kundrejt 96 të Kurtit.

Këshilli Lokal – "Mati I" - Veriu

Në 26 Qershor 2025, Isme Haziri u zgjodh kryetar, por nuk pati një garë për këtë post.

Këshilli Lokal – “Mati II” – Mati i Vjeter

Zgjedhjet për këtë këshill u anuluan.

Këshilli Lokal – Kodra e Diellit

Më 15 Maj 2025, Amir Gashi u zgjodh kryetar me aklamacion, pasi ishte i vetmi kandidat.

Këshilli Lokal – Aktashi

Zgjedhjet janë anuluar dhe nuk ka të dhëna për procesin zgjedhor.

Këshilli Lokal – Lagjja e Muhaxherëve

Më 27 Maj 2025, Kryetar i këshillit u zgjodh Dren Dauti, me 1 kandidat të vetëm për postin e kryetarit.

Këshilli Lokal – Dodona

Kryetar u zgjodh Qerim Mirena, i cili mori 182 vota në zgjedhjet që u mbajtën më 15 Maj 2023.

Këshilli Lokal – Sofalia

Kryetar u zgjodh Enver Redenica me 104 vota.

Këshilli Lokal – Taslixhe

Më 17 Maj 2023, Kryetar u zgjodh Rifat Gashi, me 97 vota.

Këshilli Lokal – Vreshtat

Kryetar u zgjodh Sezair Ruhani, me 103 vota në zgjedhjet e mbajtura më 30 Prill 2024.

Këshilli Lokal – Medrese

Zgjedhjet për këtë këshill u anuluan.

Këshilli Lokal – Kolovicë 2

Kandidat për Kryetar është Kastriot Hyseni, i cili është propozuar si i vetmi kandidat në zgjedhjet e mbajtura më 25 Qershor 2025

Këshilli Lokal – Kodra e Trimave I

Kryetar i këshillit u zgjodh Bastri Ibishi, dhe zgjedhjet janë mbajtur më 30 Qershor 2025.

Këshilli Lokal – Kodra e Trimave II

Kryetar u zgjodh Adem Sylejmani, pas një gare me Muhamed Ajeti.

Këshilli Lokal – Arbëria I

Kryetar u zgjodh Xhemail Luta, me 57 vota në zgjedhjet që u mbajtën më 4 Qershor 2024.

Këshilli Lokal – Arbëria II

Zgjedhjet për këtë këshill u anuluan.

Këshilli Lokal – Shkabaj

Kryetar u zgjodh Avni Osmani, dhe zgjedhjet u mbajtën më 13 Maj 2023.

Këshilli Lokal – Bërnice e Poshtme

Kryetar u zgjodh Bashkim Ibrahim, i cili mori 152 vota në zgjedhjet e mbajtura më 18 Prill 2024.

Këshilli Lokal – Bërnice e Epërme

Kryetar u zgjodh Veton Berisha, në zgjedhjet e mbajtura më 08 Prill 2025.

Këshilli Lokal – Trudë

Kryetar u zgjodh Gani Dobratiqi, me 109 vota në zgjedhjet që u mbajtën më 31 Maj 2023.

Këshilli Lokal – Barilevë

Kryetar u zgjodh Isa Rexha, dhe procesi i zgjedhjeve u përsërit për disa herë pas ankesës.

Këshilli Lokal – Besi

Kandidat për Kryetar është Beslim Syl, i cili është propozuar pa kundërshtarë në zgjedhjet e mbajtura më 2 Qershor 2025

Këshilli Lokal – Prugoc

Kryetar u zgjodh Osman Dragusha, në zgjedhjet që u mbajtën më 17 Maj 2023.

Këshilli Lokal – Llukar

Kryetar u zgjodh Sabedin Berisha, i cili mori 86 vota në zgjedhjet e mbajtura më 14 Maj 2025.

Këshilli Lokal – Keqekollë

Kryetar u zgjodh Avdi Aliu, dhe zgjedhjet u mbajtën më 20 Qershor 2024.

Këshilli Lokal – Dabishec

Kryetar u zgjodh Arbnor Hasimi, dhe zgjedhjet u mbajtën më 7 Maj 2024.

Këshilli Lokal – Marec

Kryetar u zgjodh Zymer Haxholli

Këshilli Lokal – Mramor

Kryetar u zgjodh Bahri Gashi, dhe zgjedhjet u mbajtën më 25 Prill 2024

Këshilli Lokal – Slivovë

Kryetar u zgjodh Fidan Xhemshiti, dhe zgjedhjet u mbajtën më 19 Nëntor 2024

Këshilli Lokal – Koliq

Kryetar u zgjodh Bedri Hajzeri, dhe zgjedhjet u mbajtën më 13 Qershor 2024

Disa lagje, si Prishtina e Re 2, Mati II dhe Aktashi, janë anuluar në mungesë të pjesëmarrësve, duke krijuar sfida organizative ose situata specifike lokale në zhvillimin e zgjedhjeve në ato zona.

Numri i pjesëmarrësve ndryshoi ndjeshëm nga një lagje në tjetrën, duke reflektuar madhësinë dhe dinamikën e ndryshme të popullsisë.

Shumica dërmuese e kryetarëve të zgjedhur janë meshkuj. Megjithëse ka shumë gra të zgjedhura si anëtare të këshillit, ato mbeten të nënreprezentuara në pozicionet kryesuese të vendimmarrjes. Ky është një aspekt që kërkon vëmendje dhe nxitje në proceset e ardhshme për të siguruar përfaqësim dhe pjesëmarrje të barabartë.

Numri i kryesisë së këshillit u vendos në bazë të vendimeve lokale, duke varur nga madhësia dhe nevojat e komunitetit.

Procesi i zgjedhjes së Këshillave Lokale në Prishtinë ka qenë një përpjekje e gjerë dhe kryesisht e suksesshme për të forcuar demokracinë në nivel bazë. Nivelet e ndryshme të pjesëmarrjes dhe konkurrencës në zgjedhje pasqyrojnë dinamikën e ndryshme lokale.

Këshillat Lokale të zgjedhur tani kanë detyrën e rëndësishme për të shërbyer si urë midis qytetarëve dhe institucioneve, duke u bërë zëri i nevojave dhe prioriteteve specifike të komuniteteve të tyre.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit nr. 03/L – 40, për Vetëqeverisje Lokale, nenit 20 paragrafi 1 të Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L–032, nenit 5, pika **d** të Ligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068 dhe nenit 14 të Rregullores (QRK) nr.19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më __/__/____ merr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E KOMISIONEVE PËR REKRUTIM TË DREJTORËVE DHE ZËVENDËSDREJTORËVE TË INSTITUCIONEVE EDUKATIVO-ARSIMORE DHE AFTËSUESE NË KRYEQYTETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

1. Miratohet- Vendimi për caktimin e komisioneve për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese në Kryeqytetin e Republikës së Kosovës në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.

2. Anëtarë të komisioneve përzgjedhëse, sipas pikës 1 të këtij vendimi janë:

2.1. Komisioni përzgjedhës për drejtorë dhe zëvendësdrejtorë për nivelin e arsimit parashkollor (IP):

1. Ardiana Ismaili- zyrtare nga DKA, kryesuese;
2. Bekë Mulaj- drejtor i institucionit arsimor, anëtar;
3. Përfaqësues nga MASHTI.

2.2. Komisioni përzgjedhës për drejtorë dhe zëvendësdrejtorë për nivelin fillor dhe të mesëm të ulët (SHFMU):

1. Ardiana Ismaili- zyrtare nga DKA, kryesuese;
2. Bekë Mulaj- drejtor i institucionit arsimor, anëtar;
3.Përfaqësues nga MASHTI.

2.3. Komisioni përzgjedhës për drejtorë dhe zëvendësdrejtorë të shkollave profesionale/IAAP-ve (SHML):

1. Ardiana Ismaili- zyrtare nga DKA, kryesuese;
2. Bekë Mulaj- drejtor i institucionit arsimor, anëtar;
3. Përfaqësues nga MASHTI.

3. Komisionet përzgjedhëse të cekura sipas pikës 2 të këtij vendimi, janë ad- hoc dhe mandati i tyre përfundon me nxjerrjen e vendimit përfundimtar për përzgjedhjen e kandidatit/ëve në pozitën/at e kërkuara me konkurs.
4. Detyrë e komisionit është përzgjedhja e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në përputhje me Rregulloren (QRK) nr.19/2024, për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i kryeqytetit dhe Drejtoria e Arsimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



PROPOZIM

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 14.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, nenit 12, paragrafi 2, të Ligjit nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.01.2025 mori këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** bartja e 45 (dyzet e pesë) normave – pozitive nga niveli arsimit të mesëm të lartë në nivelin parafillor dhe fillor mesëm të ulët.
- II. Sipas pikës I të këtij Vendimi, 18 (tetëmbdhjetë) norma-pozita do të barten në nivelin parafillor dhe 27 (njëzet e shtatë) norma- pozita do të barten në nivelin fillor dhe mesëm të ulët.
- III. Bartja e normave – pozitive si në pikën I të këtij propozimi bëhet për shkakë të rritjes dhe tejkalimit të nevojave për staf në nivelin parafillor si rrjedhojë e ndërtimit të I. P “Xixëllonja” dhe aneksit të I. P “Ardhmëria, si dhe planifikimit për hapjen e I. P- së së re në lagjen “Dardania”.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Kryeqytetit, Drejtoria e Arsimit si dhe drejtoritë dhe sektoret tjera kompetente.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

KRYESUESI I KUVENDIT

01. nr. _____, më _____

Fehmi Kupina

Të nderuar, përfaqësues të Asamblesë Komunale,

Ju njoftojmë se Drejtoria e Arsimit kërkon mbështetjen tuaj për miratimin e pikës së rendit të ditës që ka të bëjë me bartjen e pozitive të lira nga niveli i arsimit të mesëm të lartë në nivelin parafillor dhe fillor mesëm të ulët.

Për informimin tuaj të drejtë, Drejtoria e Arsimit e ka të përcaktuar numrin e normave të stafit arsimor për secilin nivel të arsimit parauniversitar. Aktualisht, bazuar në vlerësimin e gjendjes faktike, konstatojmë se kemi tejkalim të normave të lejuara në nivelet parafillor dhe fillor.

Sipas Ligjit për ndarjet buxhetore për vitin 2024, konkretisht paragrafit 2 të nenit 12, theksohet se: "Numri i të punësuarve dhe shuma përkatëse buxhetore për kategorinë e shpenzimeve për paga dhe shtesa nëpër nënprograme mund të përshtaten me vendim të Ministrit, me arsyetimin përkatës nga Organizata Buxhetore (OB), duke përjashtuar kufizimet e përcaktuara. Në rastin e OB-ve të nivelit lokal, nevojitet paraprakisht edhe vendimi i Kuvendit Komunal."

Andaj, për të mundësuar bartjen e normave të stafit arsimor nga niveli i arsimit të mesëm të lartë në nivelet parafillor dhe fillor, kërkohet mbështetja dhe miratimi juaj.

Aktualisht, në nivelin e arsimit të mesëm të lartë kemi **53 norma të lira**, ndërsa në nivelet parafillor dhe fillor vlerësojmë se kemi nevojë për bartjen e rreth **45 normave**. Në bazë të analizës së normave për nivelin parafillor propozojmë **18 norma**, ndërsa për nivelin fillor dhe mesëm të ulët **27 norma**.

Rritja dhe tejkalimi i nevojave për staf në nivelin parafillor është si rrejtillë e rritjes së kapaciteteve për fëmijë dhe edukatore, si rezultat i ndërtimit të institucionit të ri parashkollor "Xixëllonja" si dhe ndërtimit të aneksit të kopshtit "Ardhmënia".

Ndërtimi i institucionit "Xixëllonja" ka mundësuar pranimin e 120 fëmijëve të rinj, gjë që ka ndikuar në rritjen e nevojës për staf edukativ. Po ashtu, ndërtimi i aneksit të kopshtit "Ardhmënia" ka rritur kapacitetin edhe për 50 fëmijë të tjerë. Për më tepër, për vitin edukativ 2025-2026 planifikohet hapja e çerdhes së re në lagjen "Dardania", e cila gjithashtu do të kërkojë staf shtesë dhe norma të reja.

Drejtoria e Arsimit ka adresuar kërkesat për rritje të normave në Ministrinë e Arsimit, e cila në bazë të informatave i ka përfshirë ato në Grantin Specifik për Arsim, por deri më tani nuk ka pasur reflektim në rritjen e normave tona.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe përkrahjen tuaj, ju falënderojmë paraprakisht për bashkëpunimin, në të mirë të proceseve arsimore.

Të nderuar, përfaqësues të Asamblesë Komunale,

Ju njoftojmë se Drejtoria e Arsimit kërkon mbështetjen tuaj për miratimin e pikës së rendit të ditës që ka të bëjë me bartjen e pozitave të lira nga niveli i arsimit të mesëm të lartë në nivelin parafillor dhe fillor mesëm të ulët.

Për informimin tuaj të drejtë, Drejtoria e Arsimit e ka të përcaktuar numrin e normave të stafit arsimor për secilin nivel të arsimit parauniversitar. Aktualisht, bazuar në vlerësimin e gjendjes faktike, konstatojmë se kemi tejkalim të normave të lejuara në nivelet parafillor dhe fillor.

Sipas Ligjit për ndarjet buxhetore për vitin 2024, konkretisht paragrafit 2 të nenit 12, theksohet se: "Numri i të punësuarve dhe shuma përkatëse buxhetore për kategorinë e shpenzimeve për paga dhe shtesa nëpër nënprograme mund të përshtaten me vendim të Ministrit, me arsyetim përkatës nga Organizata Buxhetore (OB), duke përjashtuar kufizimet e përcaktuara. Në rastin e OB-ve të nivelit lokal, nevojitet paraprakisht edhe vendimi i Kuvendit Komunal."

Andaj, për të mundësuar bartjen e normave të stafit arsimor nga niveli i arsimit të mesëm të lartë në nivelet parafillor dhe fillor, kërkohet mbështetja dhe miratimi juaj.

Aktualisht, në nivelin e arsimit të mesëm të lartë kemi **53 norma të lira**, ndërsa në nivelet parafillor dhe fillor vlerësojmë se kemi nevojë për bartjen e rreth **45 normave**. Në bazë të analizës së normave për **nivelin parafillor propozojmë 18 norma**, ndërsa për **nivelin fillor dhe mesëm të ulët 27 norma**.

Rritja dhe tejkalimi i nevojave për staf në nivelin parafillor është si rrejllë e rritjes së kapaciteteve për fëmijë dhe edukatore, si rezultat i ndërtimit të institucionit të ri parashkollor "Xixëllonja" si dhe ndërtimit të aneksit të kopshtit "Ardhmënia".

Ndërtimi i institucionit "Xixëllonja" ka mundësuar pranimin e 120 fëmijëve të rinj, gjë që ka ndikuar në rritjen e nevojës për staf edukativ. Po ashtu, ndërtimi i aneksit të kopshtit "Ardhmënia" ka rritur kapacitetin edhe për 50 fëmijë të tjerë. Për më tepër, për vitin edukativ 2025-2026 planifikohet hapja e çerdhes së re në lagjen "Dardania", e cila gjithashtu do të kërkojë staf shtesë dhe norma të reja.

Drejtoria e Arsimit ka adresuar kërkesat për rritje të normave në Ministrinë e Arsimit, e cila në bazë të informatave i ka përfshirë ato në Grantin Specifik për Arsim, por deri më tani nuk ka pasur reflektim në rritjen e normave tona.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe përkrahjen tuaj, ju falënderojmë paraprakisht për bashkëpunimin, në të mirë të proceseve arsimore.



03 Nr. ID: 646 Dt. 23.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

	23.10.2024
Referenc-ë:	03-646
Për/ Za/ To:	z. Salvador Elmazi, Drejtor i Buxhetit, Thesari i Kosovës
CC:	Z. Xhevat Zejnullahu, Drejtor i Thesarit Z. Bekim Hamiti, Administrator i lartë i sistemit të Pagave Z. Ahmet Tolaj, zv. Udhëheqësi i Divizionit të pagave
Përmes/Preko/Through:	
Nga/ Od/ From:	znj. Jehona Lushaku Sadriu, Nënkryetare e Kryeqytetit dhe Drejtore e Drejtorisë së Arsimit
Tema/ Subjekat/Subject:	Kërkesë për bartjen e normave të mësimdhënësve

Bazuar në nenin 62 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L - 040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), nenin 57 shkronja e. të Statutit 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010 të Komunës së Prishtinës, drejtori i Drejtorisë për Arsimit lëshon këtë;

K Ë R K E S Ë

I nderuar z. Elmazi,

Përmes kësaj shkresë ju drejtohem me kërkesën për bartje të numrit total të normave të lira nga niveli i arsimit të mesëm të lartë, në nivelin e arsimit parafillor dhe fillor. Këtë kërkesë e mbështesim në nevojën e zbatimit të reformës së mësimi tërëditor për shkollat fillore në Komunën e Prishtinës.

Për informatën tuaj, Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, me qëllim të ngritjes së cilësisë në arsim, për vitin shkollor 2024-2025, ka filluar zbatimin e mësimi tërëditor në pesë (5) shkolla të Kryeqytetit. Zbatimi i kësaj reforme ka kërkuar angazhim dhe staf shtesë në nivelin e arsimit fillor.

Prandaj, duke pasur parasysh numrin jo të mjaftueshëm të normave në nivelin parafillor dhe fillor, ju lutem të vshqyrtoni mundësinë për bartjen e normave të lira nga niveli i arsimit të mesëm të lartë, në nivelin parafillor dhe fillor.

Duke shprehur në përkrahjen e tuaj dhe Thesarit për këtë kërkesë të domosdoshme,

Me respekt,

Faqe 1 nga 1

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://ee.prishtina-komuna.org>

From: Sadije Bilalli
Sent: Thursday, October 24, 2024 10:44 AM
To: SHFMU Ismail Qemali
Subject: FW: Kerkese per bartje te normave

E nderuara znj. Drejtoresh,

Ju lutem gjeni në vazhdim emalin, e dërguar nga Drejtori i Buxhetit/ MFPT

Faleminderit për mirëkuptim.

Me respekt,



Sadije Bilalli
Menaxhere personeli
Thesari i Kosovës
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Republika e Kosovës

PHONE

MOBILE

EMAIL

+383 38 200 34 066 +383 44 112 318 sadije.bilalli@rks-gov.net

Adresa: Sheshi Nënë Tereza Ndërtesa Qeveritare, 10000, Prishtinë

Ky mesazh është konfidencial. Nëse keni pranuar këtë mesazh gabimisht, ju lutem na njoftoni menjëherë me e-mail dhe fshini atë nga sistemi juaj. Ju nuk mund të kopjoni këtë mesazh ose të bëni publik përmbajtjen e tij.
This message is confidential. If you have received it by mistake, please let us know by e-mail reply and delete it from your system; you may not copy this message or disclose its contents to anyone.

From: Salvador Elmazi <salvador.elmazi@rks-gov.net>
Sent: Thursday, October 24, 2024 10:38 AM
To: Sadije Bilalli <sadije.bilalli@rks-gov.net>
Subject: FW: Kerkese per bartje te normave

Info.

From: Salvador Elmazi
Sent: Thursday, October 24, 2024 10:22 AM
To: Jehona Lushaku <Jehona.Lushaku@rks-gov.net>
Cc: Perparim Rama <perparim.rama@rks-gov.net>; Valbona Makolli <Valbona.Makolli@rks-gov.net>
Subject: RE: Kerkese per bartje te normave

E nderuar znj. Lushaku,

Kemi analizuar kërkesën e juaj dhe ju informojmë se për lëvizjen e stafit nevojitet vendimi i kuvendit të komunës.

Me saktësisht, paragrafi 2 i nenit 12 i Ligjit mbi ndarjet buxhetore për vitin 2024, thekson se numri i të punësuarve dhe shuma përkatëse buxhetore për kategorinë e shpenzimeve paga dhe shtesa nëpër nën programe mund të përshtaten me vendim të Ministrit me arsyetim përkatës nga OB, ku në rastin e OB-ve të nivelit lokal nevojitet paraprakisht edhe vendimi i Kuvendit Komunal.

Nga sqarimet e mësipërme, vendimi i kuvendit të komunës duhet të specifikojë numrin e pozitive të lira që barten dhe buxhetin përkatës për paga.

Me respekt,

Salvadori

From: Jehona Lushaku <Jehona.Lushaku@rks-gov.net>

Sent: Wednesday, October 23, 2024 3:22 PM

To: Salvador Elmazi <salvador.elmazi@rks-gov.net>

Cc: Perparim Rama <perparim.rama@rks-gov.net>; Valbona Makolli <Valbona.Makolli@rks-gov.net>

Subject: Kerkese per bartje te normave

I nderuar z. Elmazi,

shpresoj të jeshë mirë dhe punët të të shkojnë mbarë.

Po ju drejtohem me një këkesë, që është e rëndësisë së veçantë dhe e domosdoshme për arsimin në kryeqytet.

Ju lus shumë që t'a konsideroni.

Për cfarëdo paqartësie, mbes në dispozicionin tuaj.

Me respekt,

Jehona

Jehona Lushaku

Nënkryetare & Drejtore e Arsimit në Kryeqytet, Prishtinë

Deputy Mayor & Education Director in Capital City, Prishtina

E-Mail: jehona.lushaku@rks-gov.net